

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"SZABO" SH.P. K**

**Kreu I**

Themelimi , Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia.

**Neni 1**

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit.

Sot me date 20/01/2023, unë themeluesi Bledar **SZABÓ**, atësia Meleq, amësia Këze, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Fier, me adresë Lagja Kastriot; Rruga Leon Rei, Pallati 1, Hyrja 1, Ap 28 Fier, lindur më 04/10/1980, pajisur me Letemjofitim ID nr. 037015465 dhe nr. personal I36019148J, kam krijuar shoqerine "**SZABO**"shpk.

**Themelues i shoqerise "SZABO"shpk eshte :**  
Z. Bledar **SZABÓ**.

**Neni 2 - Objekti**

Objekti kryesor i Shoqërisë do të jete"

*Sherbime konsulence teknike, analiza e studim tregu.*

Gjithashtu shoqëria mund të kryejë cdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji i zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 3- Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortaku i Vetëm i Shoqërisë mund të vendosë të kufizojë kohë zgjatjen e aktivitetit me një vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**NENI 4 - Selia**

Shoqëria ka selinë e saj në adresën: Lagja Kastriot; Rruga Leon Rei, Pallati 1, Hyrja 1, Ap 28 Fier.

Shoqëria mund të hapë ose të mbyllë degë, filiale dhe / ose zyra përfaqësimi brenda Shqipërisë dhe / ose jashtë vendit, ose të krijojë shoqëri të tjera me Partnerë apo Aksionar pjesëmarrës.

**Kreu II**

**KAPITALI**

**Neni 5 – Kapitali i themeltar**



Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte ne vleren **100,000 LEK (njqind mije)** i perbere nga nje kuote.

**Ortaku themelues Z. Bledar SZABÓ** zotērues i 1 (njē) kuotē, qē pērfaqēson 100 % tē kapitalit tē shoqērisē, me njē vlerē prej **100,000 Lek (njēqind mijē)**;

#### **Neni 6 - Rritja e Zvogelimi i Kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimit te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne natyre ose ne te holla, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Nese ndonje nga ortaket refuzon te drejten nenshkrimit, kapitali mund te nenshkruhet nga ortaket e tjere. Ne kete rast, ortaket e tjere mund te ushtrojne te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit te shoqerise, lejohet nga asambleja e ortakeve e cila merr vendim ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

#### **Neni 7 - Transferimi i kuotave**

Kuotat e kapitalit te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) shitblerjes,
- c) trashegimise
- ç) dhurimit
- d) cdo menyre tjeter e parashikuar ne ligj.

Pjeset e kapitalit jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve , per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ne rruge trashegimie.

### **KREU III**

#### **ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE TE SHOQERISE**

##### **Neni 8 - Organet e Shoqerise**

Organet e Shoqerise jane:

- 1) Asambleja e Pergjithshme;



2) Administratori / ët.

## ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

### 1) Asambleja e Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise dhe perbehet nga te gjithë Ortaket e Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme eshte organi i vetem vendimmarres i Shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara me ligj.

Çdo Ortak ka te drejte te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme per te shprehur mendimin e tij dhe te votoje ne baze te kuotave qe zoteron.

Ortaku mund te perfaqesohet nga nje person tjetër, jo domosdoshmerisht Ortake, me ane te nje Prokure te Posacme. Ne çdo rast, kjo Prokure e Posacme mund te jepet vetem per nje Mbledhje te caktuar te Asamblese se Pergjithshme, dhe do te jete e vlefshme edhe per mbledhjet pasardhese me te njeitin rend dite. Administratorët nuk mund te perfaqesojne Ortakun ne mbledhjet e Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e Pergjithshme mund te mbledhet ne nje vend te ndryshem nga selia e Shoqerise, ne Republikën e Shqiperise ose jashte vendit.

Asambleja e Pergjithshme thirret nga Administratori, sipas nevojave dhe interesave te Shoqerise ose nese kerkohet nga legjislacioni ne fuqi. Asambleja e Pergjithshme mund te thirret edhe nga cdo Ortak qe zoteron te pakten 10% (dhjete per qind) te pjeses se kapitalit. Ne çdo rast, Asambleja e Pergjithshme mbledhet te pakten njehere ne vit, brenda javes se fundit te muajit Qershor, ne menyre qe te diskutoje, te shqyrtoje dhe te miratoje bilancin vjetor te vitit te kaluar fiskal.

Njoftimi per mbledhjen e Asamblese se Pergjithshme do te behet me leter rekomande me njoftim marrjeje, dhe do te dergohet ne adresat e Ortakeve te shoqerise te regjistruara ne Regjistrin e Ortakeve, ose me poste elektronike ne adresat e Ortakeve, ose me poste tek Ortaket se paku 21 (njetzet e nje) dite perpara dates se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.

Njoftimi duhet te permbaje informacion mbi ceshtjet qe do te diskutohen ne rendin e dites dhe mbi te cilat do te merret vendim, vendin, oren dhe daten e thirrjes se pare dhe te dyte, si edhe procedurat e detajuara te pjesemarrjes dhe te votimit, informacion mbi vendin dhe menyra e marrjes se dokumentacionit dhe projekt vendimeve te asamblese si edhe elementet e tjera te percaktuar nga legjislacioni ne fuqi.

Asambleja e Pergjithshme do te konsiderohet e mbledhur rregullisht edhe nese nuk ka ndjekur te gjitha formalitetet e thirrjes, nese te gjithë Ortaket qe perfaqesojne pjesen e tere kapitalit te shoqerise jane te pranishem ne mbledhje apo te perfaqesuar nga nje perfaqesues me prokure te posacme, dhe shprehen dakort per te zhvilluar mbledhjen e asamblese pavaresisht parregullsive ne thirrjen e saj.

Asambleja e Pergjithshme mund te mbahet edhe me pjesemarrjen e njerezve ne vende te ndryshme, dhe mund te mbahet permes telekonferences apo video konferences, ose mjete te tjera te ngjashme elektronike, me kusht qe te gjithë pjesemarrësit te mund te identifikoehen dhe t'i jepet mundesia per te marre pjese ne diskutimet dhe per te marre pjese ne to.

Asambleja e Pergjithshme kryesohet nga Kryetari i cili emerohet nga radhet e Ortakeve te pranishem ose te perfaqesuar ne mbledhje.

Kryetari i Mbledhjes ka kompetenca te plota per te kontrolluar prokurat e posacme dhe rregullsine e tyre, te drejten e Ortakeve dhe perfaqesuesve te tyre per te marre pjese ne Asamblene e Pergjithshme, si dhe per te percaktuar nese Mbledhja eshte thirrur rregullisht dhe nese kuorumi i nevojshem per marrjen e Vendimeve te vlefshme eshte arritur. Kryetari ka gjithashtu te drejten per te drejtuar diskutimet dhe per te percaktuar metodat dhe procedurat e votimit.

Ne rast se Shoqeria ka vetem nje Ortak qe ka fituar Kuotat e Ortakeve te tjere me ane te nje procesi ligjor dhe zoteron tere kapitalin e shoqerise, vendimet e Ortakut te vetem do te regjistrohen ne regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose fshihen.

### **Neni 9 - Kuorumi dhe Kompetencat e Asamblese se Pergjithshme**

Ne rast vendimesh te zakonshme, Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese jane te pranishem ortaket e shoqerise qe zoterojne me shume se 50% (pesedhjetepetend) te Kuotave me te drejte vote. Nese Asambleja e Pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuoromit ne thirrjen e pare, asambleja mund te mblidhet perseri me te njejtin rend dite brenda dhe jo me vone se 30( tridhete) dite pas thirrjes se pare. Vendimet e zakonshme merren me voten pro te shumices se ortakeve te pranishem apo te perfaqesuar.

Asambleja e Pergjithshme mund te marre vendime te zakonshme mbi ceshtjet e meposhtme:

- (a) peraktimin e politikave tregtare;
- (b) emerimin dhe shkarkimin e Administratorit;
- (c) emerimin dhe shkarkimin e eksperteve kontabel te autorizuar dhe likuiduesve;
- (d) miratimin e shperblimeve per personat e permendur ne paragrafet (b) dhe (c);
- (e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- (f) monitormin dhe mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori;
- (g) perfaqesimin e Shoqerise ne gjykate dhe ne proceset gjyqesore ndaj Administratorit;
- (h) cdo ceshtje tjeter te percaktuar nga ligji apo statuti.

### **Neni 10 – Administrimi**

Asambleja e Pergjithshme do te caktojte nje (1) person fizik si Administrator te shoqerise, i cili mund te jete ortak ose jo dhe qe do te jete pergjegjes per ceshtjet e perditshme te Shoqerise sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe me kete Statut.

**Administratori ushtron keto detyra:**

- (a) menaxhon shoqerine duke zbatuar politikat siç percaktohet nga Asambleja e Pergjithshme;
- (b) sigurohet qe te mbahen librat dhe dokumentet e nevojshme kontabel;
- (c) Mban dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise dhe ja paraqet ate Asamblese se Pergjithshme per miratim se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve;

- (d) krijon nje sistem paralajmerimi te hershem ne lidhje me zhvillimet qe kercenojne ekzistencen e shoqerise;
- (e) paraqet te dhenat e shoqerise per t'u regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas rastit;
- (f) raporton perpara Asamblese se Pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per punen e Shoqerise;
- (g) cdo detyre tjeter siç percaktohet me ligj ose Statut.

Administratori emerohet per nje periudhe deri ne 5 (pese) vite dhe me te drejte rizgjedhjeje. Ky emerim prodhon efekte ligjore ne daten e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Shoqeria merr angazhime me nenshkrimin e vetem te administratorit, sipas kufizimeve te parashikuara nga ligji ne fuqi dhe ne kete Statut dhe Akt Themelimi. Administratori i shoqerise ka te drejten dhe detyrimin per te perfaqesuar Shoqerine ne marrdheniet me te tretet.

#### **Neni 10.1**

#### **ADMINISTRATORI DHE AFATI I EMRIMIT TE TIJ.**

Asambleja e Pergjithshme emerom si Administrator te shoqerise:

**Z. Bledar SZABÓ**, atësia Meleq, amësia Këze, shtetas Shqiptar, lindur dhe banues në Fier, me adresë Lagja Kastriot; Rruga Leon Rei, Pallati 1, Hyrja 1, Ap 28 Fier, lindur më 04/10/1980, per nje afat 5 (pese) vjecar me te drejte rizgjedhje.

#### **KREU IV VITI FINANCIAR, DIVIDENTI**

#### **Neni 11 - Viti Financiar**

11.1 Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

11.2 Perjashtimisht viti i pare financiar fillon ne daten e regjistrimit ne QKB (Qendra Kombetare e Biznesit) dhe perfundon me 31 Dhjetor te atij viti.

#### **Neni 12 – Dividentet dhe Kapitalizimi i Fitimeve**

12.1 Permes vendimit te asamblese se pergjithshme shoqeria shperndan dividentin ne perputhje me te drejtat perkatese te ortakeve, nese:

- a) aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimin e saj;
- b) shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te paguar detyrimet qe duhet te jene te pagueshme brenda 12 muajsh.

#### **12.2 Kapitalizimi i Fitimeve**



Me vendim te Asamblese se Pergjithshmedhe ne lidhje me parimet e percaktuara ne nenin 14, te Ligjit 9901, date 14.04.2008 indryshuar, Ligj nr. 129/2014, administratori mund te vendose per te kapitalizuar fitimet.

## **KREU V**

### **SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI**

#### **Neni 13 - Prishja-Ndarja-Bashkimi**

13.1 Shoqeria mund te prishet per shkaqet e parashikuara me ligj. Ne rast te prishjes, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore duke u percaktuar kompetencat reciproke.

13.2 Shoqeria gjithashtu mund te ndahet ose te bashkohet me ane te nje vendimi te asamblese se jashte zakonshme te ortakeve.

#### **Neni 14 - Likuidimi**

14.1 Ne rast te prishjes shoqeria mund te likuidohet.

14.2 Per te administruar kete procedure, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve emerone nje ose me shume likuidatore i cili do te hartoje raportin perfundimtar mbi aktivet dhe pasivet e shoqerise, si dhe procedurat dhe kohen e duhur per likuidim.

14.3 Ne fund te procedurave te likuidimit, Asambleja e Zakonshme e Ortakeve do te vendose ne lidhje me bilancin perfundimtar, punen e bere nga likuiduesi dhe te perfundoje procesin e likuidimit.

14.4 Me likuidimin e kreditoreve likuiduesit gjithashtu do te shperndajne aktivet e mbetura te Ortakeve ne proporcion me perqindjen qe ata disponojne.

## **KREU VI**

### **Te ndryshme**

#### **Neni 15 - Gjuha dhe Zgjidhja e Mosmarreshjeve**

Çdo mosmarreshje ose mosmarreshjet ndermjet ortakeve ose ne mes tyre ne Shoqeri fillimisht do te zgjidhet ne menyre te brendshme dhe miqesisht. Nese, nje zgjidhje miqesore nuk mund te arrihet brenda 60 ditesh, çeshtja do t'ireferohet Gjykatave te Tiranes, me nje proces te rregullt qe do te zhvillohet ne Tirane, Shqiperi.

ORTAKU  
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR  
"SZABO" SH.P. K

BLENDAR

SZABO

